




REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDER KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORRUPCIE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. 2-0/DPK	Nr. Prot. Br. Prot. 01-1366/2012
Nr. i faq Broj stranica 02	Data Datum 17-04-2012
Nr. pages	Date
PRISHTINE	



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 29 paragrafi 1 pika e) të Rregullores së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 04.04.2012, nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr.AKK– 03-4814/11, për z.Hajdar Grezda, Drejtor i Bordit në KRU “RADONIQI”SH.A – Gjakovë, për shkak se zyrtari i lartë publik ka shmangur gjendjen e konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Në rastin e shqyrtuar për konflikt të interesit me numër protokolli AKK–03-4814/11, që ka të bëjë me z.Hajdar Grezda, Drejtor i Bordit në KRU “RADONIQI”SH.A, janë zhvilluar të gjitha procedurat për të vërtetuar gjendjen e konfliktit të interesit.

Pas zhvillimit të procedurës dhe analizimit të gjendjes është konstatuar se Zyrtari i lartë publik, gjatë kohës së ushtrimit të funksionit Publik ka qenë i regjistruar në ARBK, si person i autorizuar në biznesin më emër “Skimarine” Sh.P.K. e që sipas Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik Nr.04/L-051, kjo situatë ka paraqitur konflikt të interesit, andaj Agjencia kundër Korrupsionit e ka njoftuar zyrtarin me shkresën e parë se ka filluar procedura e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të Konfliktit të Interesit dhe se ka të drejtë në afatin prej 15 ditësh të njoftohet me faktet që posedon Agjencia.

Pas këtyre procedurave zyrtari i lartë z. Hajdar Grezda ka ardhur në Agjenci dhe kemi biseduar për gjendjen dhe faktet që disponon Agjencia lidhur me gjendjen e mundshme të Konfliktit të interesit, z. Grezda gjatë takimit është pajtuar për situatën mirëpo është arsyetuar se nuk ushtron pozitë në këtë biznese pasi që ka dhënë dorëheqje me 13.09.2011 por të dhënat kanë mbetur të regjistruara dhe nuk janë ndryshuar në Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve, dhe është zotuar

se ne afatin ligjore do të kërkoj të bëhen ndryshimet e kërkuara për të shmangur Konfliktin e mundshëm te Interesit.

Zyrtari i Lartë z. Hajdar Grezda brenda afatit ligjore ka sjellë dëshmitë nga ARBK-ja, se janë bërë ndryshimet e kërkuar dhe nuk ushtron me funksionin e agjentit të regjistruar (Personit të autorizuar).

Konstatohet se z. Hajdar Grezda ka sjellë dokumentet e nevojshëm që dëshmojnë se nuk është më në pozitën e personit të autorizuar ne biznesin më emër "Skimarine" Sh.P.K.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Hasan Preteni
Drejtore i Agjencisë kundër Korrupsionit

